



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.5/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së datës 25.03.2024 të parashtruar nga ankuesi A. Sh. [redacted] nga Gjilani, për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B. S. [redacted] - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, më datë 29.03.2024, mori këtë:

**AKTVENDIM**

**REFUZOHET e pabazuar** ankesa e parashtruar nga ankuesi A. Sh. [redacted] nga Gjilani, e datës 25.03.2024, për inicimin e procedurës disiplinore konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtarit Berat Spahiu - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan.

**Arsyetim**

Më datë 25.03.2024, parashtruesi i ankesës A. Sh. [redacted] ka paraqitur ankesë urgjente, duke kërkuar nga autoriteti kompetent që të iniciojë procedurë disiplinore ndaj gjyqtarit B. S. [redacted].

Në ankesë, pretendimet e të njëjtit konsistojnë në mënyrën e trajtimit të lëndës C.nr.1923/21, lëndë kjo e kthyer në rivendosje nga gjykata e shkallës së dytë, duke konsideruar se me aktgjykimin C.nr.809/16, gjyqtari B. S. [redacted] ka keqpërdorë pozitën zyrtare dhe ka favorizuar palën kundërshtare. Tutje, ka konsideruar se të gjitha veprimet procedurale në lidhje me këtë lëndë nuk kanë reflektuar si veprime për trajtim të shpejtë, të drejtë, ligjor, efikas dhe të paanshëm të lëndës. Për këtë, ka theksuar se nuk është proceduar në mënyrë urgjente me lëndën e kthyer në rigjykim, sipas nenit 199 të LPK-së. Ka kontestuar edhe mënyrën e vendosjes të gjyqtarit të çështjes sipas propozimeve të parashtruesit të ankesës. Nga kryetari i gjykatës ka kërkuar që të iniciohet procedura disiplinore ndaj gjyqtarit të çështjes Berat Spahiu dhe i njëjti të sanksionohet proporcionalisht me shkeljet e kryera dhe në pajtim me ligjin.

Ankesës së tij, parashtruesi i ka bashkëngjitur aktgjykimin e kësaj gjykate, C.nr.809/2016 të datës 07.03.2018; aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.229/18 të datës 07.10.2021; ankesat e parashtruesit të datës 28.03.2022, 23.05.2022; kërkesën për përjashtim të datës 25.05.2022; aktvendimin

sipas kësaj lënde për ndërprerje të procedurës për shkak të inicimit të kërkesës për përjashtim të gjyqtarit të datës 27.05.2022; ankesat e parashtruesit të datës 19.09.2022, 29.09.2022; procesverbalin e seancës përgatitore të datës 03.10.2022; ankesën tjetër të datës 04.04.2023; aktvendimin për plotësim të datës 07.08.2023; ankesën tjetër të datës 24.08.2023; padinë e parashtruesit të ankesës të datës 25.08.2023; parashtrësën për precizim subjektiv dhe objektiv të datës 25.08.2023; aktvendimin për vendosje sipas parashtrësave të parashtruesit të ankesës të datës 28.08.2023; dhe ankesën tjetër të datës 01.09.2023.

Kryetari i gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës, ka kërkuar nga gjyqtari i çështjes që të deklarohet rreth pretendimeve të palës ankuese.

Gjyqtari B. S. në deklaratën e tij të datës 28.03.2024 ka theksuar se ankesa e parashtruesit duhet të hedhet e palejuar, meqë i njëjti nuk është palë në procedurë, por ka përfaqësuar palën paditëse e cila tashmë ka vdekur, që nënkupton se ankuesit i është shuar autorizimi dhe për shkak se këto pretendime janë të njëjta dhe të përsëritura tash e shumë herë, e për të cilat edhe është vendosur paraprakisht, andaj për shkak të parimit "ne bis in idem", kjo ankesë nuk duhet fare të shqyrtohet. Në cilësinë e gjyqtarit të ngarkuar me zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore ka shpjeguar në mënyrë kronologjike të dhënat në bazë të të cilave, sipas gjyqtarit të çështjes deri te zvarritja e procedurës ka ardhë për shkak të parashtrësave të ankuesit për përjashtim dhe fillim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit, sa herë që është caktuar seancë, me ç'rast është pritur të merret vendim për këto parashtrës. Ka theksuar se sa herë të ketë kërkesa për përjashtime apo ankesa, gjyqtari i çështjes nuk mund të procedojë lëndën derisa të vendoset për këto kërkesa. Sa i përket kronologjisë së çështjes, ka shtjelluar se paditësja E. Sh. më datë 03.10.2016 ka paraqitur padi për pengim posedim në këtë gjykatë, ndërsa më datë 24.01.2017 ka ndryshuar bazën juridike të padisë nga pengim posedimi në vërtetimin e pronësisë dhe servitutit real. Më datë 07.04.2017 me aktvendim procedural është lejuar ndryshimi i bazës së padisë. Më datë 20.04.2017 është zgjeruar padia në kuptim subjektiv, e më datë 01.06.2017 përfaqësuesi i paditëses është tërhequr nga pjesa e padisë sa i përket vërtetimit të servitutit real dhe është proceduar me kërkesën për vërtetimin e pronësisë. Më datë 06.07.2017 me aktvendim procedural është pranuar kundërpadia e të paditurve, kurse në seancën për shqyrtimin kryesor të datës 06.11.2017 është tërhequr padia ndaj njërit të paditur, H. Sh. Më datë 07.03.2018 është marrë aktgjykimi sipas kësaj lënde, ndërsa me aktvendimin e datës 07.10.2021 është kthyer lënda pjesërisht në rigjykim nga gjykata e shkallës së dytë. Nga muaji Qershor/Korrik i vitit 2019 ka qenë i caktuar si Ushtrues Detyre i Mbikëqyrësit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, deri më datë 01.03.2021, kur edhe është kthyer në këtë gjykatë. Parashtruesi i ankesës më datë 25.10.2019, edhe para se të kthehej gjyqtari i çështjes në Gjilan kishte ushtruar kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj tij, e cila kërkesë ishte refutuar sipas aktvendimit AD nr.03/19 të datës 31.10.2019, e pastaj edhe është hedhur nga Gjykata Supreme sipas aktvendimit GJS-2019-009 të datës 25.11.2019. Më datë 28.09.2020 është njoftuar nga Prokuroria Themelore në Gjilan se është hedhë kallëzimi penal i ushtruar ndaj tij, ish kryetarit P. A., kryetarit V. S. dhe gjeodetit F. Sh. nën dyshimin e keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Më datë 07.02.2022, paditësja ka ushtruar kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të çështjes; më datë 28.03.2022 ka ushtruar përsëri ankesë ndaj gjyqtarit; më datë 29.03.2022 ka ushtruar ankesë ndaj ish kryetarit të gjykatës, R. A.; më datë 23.05.2022 ka ushtruar përsëri ankesë; e më datë 25.05.2022 ka njoftuar gjyqtarin e çështjes se ka ushtruar ankesë në KGJK dhe kërkesë për përjashtim të

gjqtarit; ndërsa më datë 26.05.2022 ka dhënë deklaratë për kërkesën për përjashtim. Për fund ka njoftuar se lënda C.nr.1923/2021 gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës sipas ankesës së përfaqësuesit të paditëses dhe se në momentin e kthimit të saj do të procedojë çështjen.

Deklaratës së tij, gjyqtari i ka bashkëngjitur ankesën e parashtruesit të datës 25.03.2024, parashtrësën për precizim të datës 25.08.2023, ankesën drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimin C.nr.809/16 të datës 07.03.2018, njoftimin e KGJK nr.08/1108 të datës 30.05.2022, kërkesën për fillimin e hetimeve të datës 25.10.2019, aktvendimin Ad.nr.03/1 të datës 31.10.2019, kërkesën drejtuar KGJK-së të datës 09.01.2020, ankesën drejtuar Prokurorisë Themelore në Gjilan të datës 19.07.2021, vendimin e Gjykatës Supreme GJS-2019-009 të datës 25.11.2019, ankesën e datës 23.05.2022, kërkesën për përjashtim dhe ankesë të datës 25.05.2022, ankesën e datës 28.03.2022, ankesën e datës 29.03.2022, kërkesën e datës 06.06.2022, njoftimin për hedhje të kallëzimit penal PP/l.nr.161/2020 të datës 28.09.2020, aktvendimin AD.GJTH.GJ.nr.5/2023 të datës 29.09.2023, aktvendimin CN.nr.101/2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 09.08.2022, aktvendimin C.nr.1923/2021 të datës 26.01.2022, aktvendimin për ndërprerje të procedurës të datës 27.05.2022, aktvendimin për rregullim të padisë të datës 03.10.2022, procesverbalin e seancës përgatitore të datës 03.10.2022, procesverbalin e seancës përgatitore të datës 07.06.2022 dhe certifikatën e vdekjes së paditëses Emine Shabani.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe deklaratës së gjyqtarit të çështjes, sipas vlerësimit të kryetarit të kësaj gjykate, ankesa e parashtruesit e dt. 25.03.2024, është e pabazuar dhe pretendimet e të njëjtës nuk e justifikojnë iniciimin e procedurës disiplinore.

Deri te një përfundim i tillë kryetari i gjykatës erdhi pas vlerësimit dhe analizimit me shumë kujdes të pretendimeve të palës ankuese të paraqitura në ankesë dhe deklaratës në përgjigje të ankesës nga gjyqtari i çështjes, ku sipas kryetarit të kësaj gjykate, veprimet e gjyqtarit B. S. nuk përbëjnë shkelje disiplinore. Lidhur me pretendimet e ankuesit sa i përket keqpërdorimit të pozitës zyrtare, favorizimit në vendosje dhe mënyrës së vendosjes, kryetari i gjykatës nuk u lëshua në të njëjtat, meqë këto pretendime i përkasin tjetër procedure dhe atakimit të vendosjes me mjete të rregullta e të jashtëzakonshme juridike. Sa i përket pretendimit se gjyqtari nuk ka ndërmarrë veprime procedurale me kohë për trajtimin e çështjes së kthyer në rigjykim sipas nenit 199 të LPK-së, kryetari i kësaj gjykate ka gjetur se me rastin e kthimit të çështjes në këtë gjykatë, më datë 25.05.2022 është kërkuar përjashtimi i tij nga parashtruesi i ankesës, e menjëherë më datë 27.05.2022 është ndërprerë procedura për vendosje sipas kërkesës për përjashtim; është mbajtur seanca përgatitore më datë 07.06.2022 dhe pastaj më datë 03.10.2022; është kthyer në plotësim padia më datë 07.08.2023; dhe është vendosur sipas parashtrësave të ankuesit me aktvendimin e datës 28.08.2023 (prova këto të sjellura edhe nga vet ankuesi). Nga këto veprime, kryetari i gjykatës vlerëson se gjyqtari i çështjes ka vepruar sipas çështjes së kthyer në rigjykim, duke marrë për bazë prioritetin e lëndës dhe brenda kohës së arsyeshme e cila justifikohet nga numri i madh i lëndëve në gjykatë dhe në zyrën e gjyqtarit të çështjes, si dhe pritjes për vendosje lidhur me kërkesat/ankesat e parashtruesit, të cilat e kanë prolonguar caktimin e shqyrtimit gjyqësor, e çdo veprim i ndërmarrë nga ana e gjyqtarit është brenda funksionit dhe mandatit të tij. Ankuesi ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike ligjore

për të kundërshtuar një vendim që e konsideron jo të drejtë dhe të ligjshëm, ndërsa këto pretendime nuk mund të prodhojnë efekt në procedurë disiplinore.


Për më tepër, kryetari i kësaj gjykate gjatë shqyrtimit të parashtrësive të bashkëngjitura si në ankesën e parashtruesit, edhe në deklaratën e gjyqtarit të çështjes, ka gjetur se A. Sh. [redacted] pas çdo veprimi të ndërmarrë ka parashtruar kërkesë apo ankesë lidhur me atë veprim, ndërsa deri më tani as në procedurë penale e as të shkeljeve disiplinore, nga asnjë instancë nuk është gjetur ndonjë shkelje e gjyqtarit të çështjes. Në bazë të vlerësimit të lirë të kryetarit, veprimet e tilla të parashtruesit të ankesës përbëjnë zvarritje të procedurës.

Kryetari i kësaj gjykate, ka parasysh kërkesën e gjyqtarit të çështjes për hedhje të ankesës të parashtruesit, mirëpo vlerëson se meqë i njëjti ka pasur cilësinë e përfaqësuesit të palës në çështjen kontestimore C.nr.1932/2021 dhe ankesën e ka drejtuar lidhur me veprimin e ndërmarrë nga gjyqtari i çështjes për procedimin e lëndës pas kthimit në rigjykim, gjatë kohës sa të njëjtit nuk i është shuar autorizimi për shkak të vdekjes së palës që e përfaqësonte, se për këtë ankesë duhet të vendos mbi baza meritore.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e parashtruesit A. Sh. [redacted] nga Gjilani, e datës 25.03.2024, është e pabazuar dhe për të njejtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i Gjykatës,

Ventur Salihu



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Gjyqtarit B. S. [redacted],
2. Parashtruesit të ankesës,
3. KGJK-së
4. Dosjës së lëndës.